

STATUT

I

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

„REJA „ SH . P . K .

PERSONI QE FIRMOS ME POSHTE :

**Z. FATOS MIRACI , I BIRI I HASANIT DHE I SARES , LINDUR NE TIRANE , ME 07 . 04 . 1953 ,
BANUES NE TIRANE , LAGJIA NR. 8 , RRUGA „ MILTO TUTULANI „ , ME SHTETESI SHQIPTARE,
ME NR. ID F 30407123E**

**KA HARTUAR SI ME POSHTE VIJON , STATUTIN E NJE SHOQERIE ME PERGJEGJESI TE
KUFIZUAR .**

KREU I

FORMA , EMERTIMI I SHOQERISE , OBJEKTI , SELIA , KOHEZGJATJA

NENI 1

FORMA

**KRIJOHET NJE SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR , E CILA E USHTRON VEPRIMTARINE
E SAJ NE PERPTHJE ME LEGJISLACIONIN SHQIPTAR NE FUQI DHE VECANERISHT , POR JO
EKSKLUZIVISHT , LIGJIN NR. 7638 , DT. 19.11.1992 „ PER SHOQERITE TREGETARE „ , AKTET E
TJERA LIGJORE QE DO TE JENE NE FUQI GJATE VEPRIMTARISE SE SHOQERISE , SI DHE ME
DISPOZITAT E KETIJ STATUTI .**

NENI 2

EMERTIMI I SHOQERISE

EMERTIMI I SHOQERISE ESHTË „REJA „ SH . P . K .

NENI 3

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE ESHTË :

- PROJEKTIMI , PRODHIMI , NDERTIMI DHE MONTIMI I NDERTIMEVE CIVILE , INDUSTRIALE
, TURISTIKE DHE BUJQESORE.**

- **PUNIME KARPENTERIE TE TE GJITHE LLOJEVE**
- **PROJEKTIMI , PRODHIMI , NDERTIMI DHE MONTIMI I SISTEMEVE TEKNOLOGJIKE DHE IMPIANTEVE E MAKINERIVE, I AUTOMATIZMAVE TE TYRE DHE I SISTEMEVE AUTOMATIKE NE PERGJITHESI.**
- **PROJEKTIMI , PRODHIMI , NDERTIMI DHE MONTIMI I OBJEKTEVE SPORTIVE**
- **PROJEKTIMI, PRODHIMI , NDERTIMI DHE MONTIM PEISAZHI (SISTEMIME LULISHTESH,VEPRA ARTI , DEKOR , ETJ)**
- **PROJEKTIM , PRODHIMI , NDERTIMI DHE MONTIMI INTERIERESH , DISAJNI INDUSTRIAL, ETJ.**
- **PROJEKTIMI , PRODHIMI DHE MONTIMI I SISTEMEVE HIDROSANITARE , TERMOTEKNIKE , TE VENTILIMIT , KONDICIONIMIT TE AJRIT, TE FURNIZIMIT ME GAZ ,TE ENEVE NEN PRESION DHE MIREMBAJTJA E TYRE , ETJ.**
- **PROJEKTIMI , PRODHIMI DHE MONTIMI I SISTEMEVE TE UJSJELLESAVE , TE TRAJTIMIT TE UJIT , TE MBETURINAVE , ETJ**
- **PUNIME RESTAURIMI NE GODINA CIVILE , EKONOMIKE , VESHJE FASADSH , RESTAURIM I MONUMENTEVE TE KULTURES , ETJ.**
- **PUNIME ME METAL , DRU , XHAM , PLASTIKE, ETJ.**
- **PUNIME BOJATISJE , HIDROIZOLOIMI , TERMOIZOLIMI , AKUSTIK , KUNDRA ZJARRIT ,ETJ**
- **PUNIME MONTIMI TE IMPIANTEVE TE PRODHIMIT DHE TE SHPERNDARJES SE ENERGJISE**
- **IMPORTIMI DHE EKSPORTIMI I TE GJITHE ELEMENTEVE QE BEJNE PJESE NE FUSHAT E MESIPERME TE AKTIVITETIT TE SHOQERISE**
- **PRODHIMI, TRGETIMI , IMPORTIMI DHE EKSPORTIMI I PRODUKTEVE TE TE GJITHE LLOJEVE, SI GJYSME FABRIKAT APO PRODUKT I GATSHEM , I LENDEVE TE PARA , I NYJEVE , ATRECATURAVE TE NEVOJSHME PER PERPUNIMIN E TYRE .**
- **PUNIME TE NDRYSHME NE SEKTORIN MEKANIK , ELEKTROMEKANIK ,ELEKTRONIK DHE PLASTIK.**
- **PJESEMARJE NE NDERMARJE TE NATYRES SE PRODHIMEVE TE MESIPERME .**

- **IMPORTIMI DHE EKSPORTIMI I MALLRAVE TE NDRYSHME INDUSTRIALE , BUJQESORE , TE NDERTIMEVE PUBLIKE DHE PRIVATE , TE OBJEKTEVE TE PRODHIMIT , TE INFRASTRUKTURES PUBLIKE OSE PRIVATE , TURIZMIT , ETJ.**

NENI 4

SELIA E SHOQERISE

SELIA E SHOQERISE NDODHET NE RRUGEN „ VANGJEL NOTI „ ISH KOMBINATI „ JOSIF PASHKO „ LAPRAKE – TIRANE .

NENI 5

KOHEZGJATJA E SHOQERISE 30 (TRIDHJETE) VJET , DUKE FILLUAR NGA DATA E RREGJISTRIMIT NE RREGJISTRIN TREGETAR TE GJYKATES SE RRETHIT TIRANE . KJO PERIUDHE, MUND TE ZGJATET PERTEJ KETIJ AFATI, OSE TE SHKURTOHET, KUR SHOQERIA PRISHET PARA KOHE .

KREU II

KAPITALI THEMELTAR , KONTIBUTET , PJESET E KAPITALIT THEMELTAR

NENI 6

KAPITALI THEMELTAR

KAPITALI THEMELTAR ESHTË 100'000 LEKE .

AI ESHTË I NDARE NE 100 PJESE, PLOTESISHT TE SHLYERA , ME VLERE 1000 LEKE SECILA, TE RENDITURA SIPAS NUMRIT TE SERISE, NGA NJE DERI NE 100.

FONDET, QE RRJEDHIN, NGA SHLYERJA E PJESEVE, DEPOZITOHEN NE BANKE , PER LLOGARI TE SHOQERISE, QE KRIJOHET .

NE RAST TE ZMADHIMIT TE KAPITALIT THEMELTAR, NEPERMJET SHTIMIT TE PJESEVE TE REJA , ZMADHIMI I KAPITALIT VENDOSËT NGA ORTAKU I VETEM.

SHOQERIA MUND TE ZVOGELOJE KAPITALIN E SAJ . ZVOGELIMI I KAPITALIT VENDOSËT NGA ORTAKU I VETEM.

NENI 7

PJESET E KAPITALIT THEMELTAR

ZOTI FATOS MIRACI, MERR 100 PJESE TE KAPITALIT THEMELTAR, TE RENDITURA NGA NUMRI I SERISE 1 DERI NE NUMRIN E SERISE 100.

NENI 8

LENIA DHE TRANSFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT

PJESET E KAPITALIT THEMELTAR JANE LIRISHT TE TRANSFERUESHME, ME RRUGE TRASHEGIMIE DHE NDERMJET PARAARDHESVE DHE PASARDHESVE.

PJESET E KAPITALIT THEMELTAR MUND T'JU TRANSFEROHEN TE TRETEVE VETEM ME MIRATIMIN E ORTAKUT TE VETEM, QE ZOTERON TE GJITHE PJESET E KAPITALIT.

KREU III

MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I SHOQERISE

NENI 9

ORTAKUT I VETEM I SHOQERISE, PERBALLON HUMBJET E SAJ DERI NE KUFIRIN E VLERES SE KONTRIBUTIT TE TIJ NE KAPITALIN THEMELTAR.

ORTAKUT I VETEM, PERCAKTON SHPERBLIMIN E ADMINISTRATOREVE DHE TE EKSPERTIT KONTABEL TE AUTORIZUAR, VENDOS PER PROBLEMET E TJERA TE DREJTIMIT TE SHOQERISE TE PARAQITURA NGA ADMINISTRATORET, ETJ.

ORTAKUT I VETEM VENDOS PER CESHTJE TE TILLA SI:

- NDRYSHIMET NE STATUT,**
- MBI KOMPETENCAT E LIKUIDATOREVE,**
- TRANSFERIMIN E PJESEVE TE KAPITALIT THEMELTAR TEK TE TRETET,**
- SHNDERRIMI I SHOQERISE NE SHOQERI TE FORMAVE TE TJERA, ETJ.**

ORTAKUT I VETEM, NE MBLEDHJEN E PARE, MUND TE MARRE VENDIME QE KOSIDEROHEN TE VLEFSHME.

NENI 10

ADMINISTRIMI

SHOQERIA ADMINISTRROHET NGA NJE OSE DISA ADMINISTRATORE, TE CILEVE U JANE BESUAR TE GJITHA PLOTFUQITE PER ADMINISTRIM TE ZAKONSHEM DHE TE JASHTEZAKONSHEM , PERJASHTUAR ATO QE LIGJI DHE STATUTI BASHKENGJITUR JA JEP SHPREHIMISHT ORTAKUT TE VETEM .

ADMINISTRATORI, EMEROHET DHE SHKARKOHET ME MIRATIMIN E ORTAKUT TE VETEM. EMERIMI I TIJ BEHET PER NJE KOHE ZGJATJE PREJ PESE VJETESH NGA EMERIMI , ME PERJASHTIM TE DOREHEQJES, OSE TE SHKARKIMIT TE PARAKOHSHEM .

ADMINISTRATORI, ESHTË PERGJEGJËS NDAJ SHOQERISE OSE NDAJ TE TRETËVE , QOFTE PER SHKELJE LIGJORE, QOFTE PER SHKELJE TE STATUTIT, OSE PER FAJE TE KRYERA GJATE ADMINISTRIMIT TE TIJ.

NEPERMJËT KETIJ AKTI, EMEROHET ADMINISTRATOR I SHOQERISE Z. FATOS MIRACI , TE CILIT I JEPEN TE GJITHE KOMPETENCAT , QE AI I PRANON , PER TE KRYER TE GJITHE FORMALITETET PER KRIJIMIN E SHOQERISE , PARASHIKUAR SIPAS LIGJIT NE FUQI .

AI ESHTË I AUTORIZUAR TE VEPROJE NE EMER TE SHOQERISE QE KRIJOHET, DERI NE RREGJISTRIMIN E SAJ NE GJYKATE , VECANERISHT, AI ESHTË I PAISUR ME NJE MANDAT PER TE KRYER AKTE DHE PER TE MARRE ANGAZHIME, NE EMER TE SHOQERISE , TE CILATI KALOJNE SHOQERISE NGA MOMENTI I RREGJISTRIMIT .

PERVEC TE TJERAVE, ADMINISTRATORI ESHTË I NGARKUAR PER TE KRYER AKTE DHE ANGAZHIME, QE JANE NE PERPËTHJE ME OBJEKTIN E SHOQERISE DHE KOMPETENCAT E TIJ .

PASI TE BEHET RREGJISTRIMI I SHOQERISE, KETO AKTE DHE ANGAZHIME, I NENSHTROHEN MIRATIMIT TE ASAMBLESE, JO ME VONE SE SA DATA E MBLEDHJES SE PARE TE SAJ, QE SHQYRTON DHE VENDOS MBI LLOGARITE E VITIT TE PARE FINANCIAR .

KY MIRATIM , BEN AUTOMATIKISHT KALIMIN E KETYRE AKTEVE DHE ANGAZHIMEVE NE NGARKIM TE SHOQERISE .

NENI 11

EKSPERTET KONTABEL TE AUTORIZUAR .

NE RAST NEVOJE, OSE NE SE E KERKON LIGJI, KONTROLLI I SHOQERISE KRYHET NGA NJE EKSPERT KONTABEL I AUTORIZUAR , I EMRUAR PER TRE VITE DUKE FILLUAR NGA DATA E EMERIMIT TE TIJ ME MUNDESI RIZGJEDHJE .

SHKARKIMI I EKSPERTIT KONTABEL TE AUTORIZUAR VENDOSSET NE TE NJEJTAT KONDITA SI EMERIMI , NE RAST SE VEREHEN GABIME OSE BEHET E PAMUNDUR KRYERJA E DETYRES .

KREU IV

VITI FINANCIAR , LLOGARITE VJETORE , NDARJA E FITIMEVE

NENI 12

VITI FINANCIAR , LLOGARITE VJETORE

CDO VIT FINANCIAR, FILLON ME 1 JANAR DHE PERFUNDON ME 31 DHJETOR .

LLOGARITE VJETORE , INVENTARI , RELACIONET MBI OPERACIONET E VITIT FINANCIAR DHE RAPORTET E VECANTA TE HARTUARA NGA ADMINISTRATORI DHE EVENTUALISHT NGA EKSPERTI KONTABEL I AUTORIZUAR , MIRATOHEN NGA ASAMBLEA .

MIRATIMI I DOKUMENTAVE MBI VEPRIMTARINE VJETORE, BEHEN BREND A NJE AFATI PREJ 6 MUAJSH , NGA DATA E MBYLLJES SE VITIT FINANCIAR .

NJE HERE NE VIT, DETYRIMISHT BEHET REVIZIONI I LLOGARIVE NGA EKSPERTET KONTABEL TE APROVUAR NGA ORTAKU I VETEM

SHPENZIMET PER KETE REVISION, JANE NE NGARKIM TE SHOQERISE .

SHOQERIA ESHT E DETYRUAR, T'I VERE NE DISPOZICION EKSPERTIT NE FJALE, TE GJITHE DOKUMENTACIONIN E NEVOJSHEM

NENI 13

DIVIDENTET

PAS MIRATIMIT TE LLOGARIVE VJETORE DHE EVIDENTIMIT TE EKZISTENCES SE FITIMEVE , ASAMBLEA PERCAKTON PJESEN QE I TAKON ORTAKUT TE VETEM NE FORMEN E DIVIDENTEVE MBI FITIMIN .

FITIMI , QE DO TE NDAHET, PERBEHET NGA FITIMI FINANCIAR , TE CILIT I JANE ZBRITUR SHUMAT E LENA MENJANE PER FONDIN REZERVE TE DOMOSDOSHEM (5 % E FITIMIT TE CDO VITI , DERI SA KY FOND TE ARRIJE VLEREN E 1/10 E KAPITALIT THEMELTAR) DHE NGA ANA TJETER I JANE ZBRITUR OSE I JANE SHTUAR RESPEKTIVISHT HUMBJET APO FITIMET E MBARTURA NGA VITET E MEPARSHME .

KREU V

ZGJATJA E AFATIT , PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

NENI 14

PRISHJA

SHOQERIA PRISHET ME PERFUNDIMIN E AFATIT TE PERCAKTUAR NE NENIN 5 TE KETIJ STATUTI, ME PERJASHTIM TE RASTEVE KUR BEHET ZGJATJA E AFATIT SIPAS NENIT 15 , OSE KUR KA NJE PRISHJE TE PARAKOHESHME, PER ARSYET E PARASHIKUARA ME LIGJ

NENI 15

LIKUIDIMI

SHOQERIA HYN NE PROCESIN E LIKUIDIMIT, QE NE MOMENTIN E PRISHJES SE SAJ . PER KRYERJEN E KETIJ PROCESI, ASAMBLEA EMERON NJE OSE DISA LIKUIDUES , TE CILET I PARAQESIN ASAJ RAPORTIN MBI GJENDJEN E AKTIVIT DHE PASIVIT TE SHOQERISE , MBI NDJEKJEN E OPERACIONEVE TE LIKUIDIMIT DHE MBI AFATIN E NEVOJSHEM TE PERFUNDIMIT TE TYRE .

NE FUND TE PROCESIT TE LIKUIDIMIT, ASAMBLEA VENDOS , MBI BILANCIN PERFUNDIMTAR FINANCIAR , MBI AKTIN E RREGULLSHMERISE SE PUNES SE LIKIDUESIT DHE MBI MBYLLJEN E PROCESIT TE LIKUIDIMIT .

MBAS PAGIMIT TE KREDITOREVE DHE SHLYERJES SE PJESEVE TE KAPITALIT THEMELTAR TEK KONTRIBUESIT PERKATES , LIKUIDUESI NDAN KAPITALET E MBETURA.

KREU VI

DISPOZITAT TE FUNDIT

NENI 16

SHNDERRIMI I SHOQERISE

SHNDERRIMI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR NE SHOQERI KOLEKTIVE OSE NE SHOQERI KOMANDITE, APO NE SHOQERI ANONIME MUND TE KRYHET VETEM ME MIRATIMIN E ORTAKUT TE VETEM .

NENI 17

MOSMARVESHJET

TE GJITHA MOSMARREVESHJET QE MUND TE LINDIN GJATE EKZISTENCES SE SHOQERISE OSE GJATE PERIUDHES SE LIKUIDIMIT , DO T'I PARAQITEN PER ZGJIDHJE GJYKATAVE KOMPETENTE SHQIPTARE .

KY STATUT ESHTË HARTUAR NE TIRANE ME 27.09.2023, NE TIRANE NE KATER EKZEMPLARE, DUKE PATUR TE GJITHE TEKSTET FUQI TE BARABARTE .